



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kultur, Omladinu i Sport

-XIII- Nr. i prot. 30 Më 31/12 2025
Br. prot. Dt. RAHOVEC - ORAHOVAC



RAPORTI JANAR - DHJETOR 2025
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Letërnjoftimi i shkurtër lidhur me Kulturën, Rinin dhe Sportin në Rahovec.

Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Kosovës. Është ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte antike të trashëguara nga epokat e hershme ilire-romake, objekte të trashëgimisë arkitekturore, shpirtërore, fetare, etnologjike etj. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/ arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm arkeologjik, shpella, trashëgimi arkitekturore dhe fetare. Në komunën e Rahovecit zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore, rinore e sportive, aktivitete muzikore, teatrale, bibliotekare, ekspozita, festivale e aktivitete të ndryshme kulturo. Aktivitete të ndryshme zhvillohen në qendrat kulturore në Rahovec, Krushë të Madhe, Hoçë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc e gjetkë. Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi", me degët në Krushë të Madhe, Ratkoc e Hoçë të Madhe, qendrat sportive në Rahovec, palestra "Mizahir Isma", terrenet e sportit në Krushë të Madhe, Xerxë, Ratkoc, Dejnë dhe në disa lagje të qytetit, ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e sportit e rekreacionit. Po ashtu, funksionojnë shoqëritë kulturore-artistike, grupet muzikore e artistike, shoqatat e ndryshme, një qendër rinore aktive, që zhvillojnë aktivitete në këto objekte kulturore, rinore e sportive. Ndër aktivitetet kryesore kulturore e promovuese që organizohen në komunën e Rahovecit janë; festivali i folklorit "Anadrinia Jehon" festa e Vjeljes së rrushit "Hardh Fest", "Agrofest", Festivali Ndërkombëtar i Poezisë, si dhe aktivitete të ndryshme periodike kulturore, rinore, sportive e promovuese.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport e përbërë prej tre sektorëve: Kulturë, Rini dhe Sport, me një buxhet të caktuar, i mbulon tre fusha të rëndësishme në jetën e përditshme.

Aktivitetet që i përfshin drejtorja janë: aktivitetet rinore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikë, art.

- Në raport të punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekte, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.
- Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe, është angazhuar që të gjitha projekte e aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.

- Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara përgjatë kësaj periudhe.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport poashtu trajton kërkesat e palëve për shfrytëzimin e këtyre objekteve kulturore e sportive:

- Shtëpia e Kulturës në: Rahovec, Ratkoc, Xërxë, Krushë të Madhe dhe Drenoc.
- Bibliotekën "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, Krushë të Madhe dhe Hoçë të Madhe.
- Stadiumin "Jahja Danuza" në Rahovec dhe fushat tjera sportive.
- Palestrën "Mizahir Isma".

Përveq buxhetit të caktuar komunal, drejtorja ka bërë përpjekje për të gjetur edhe burime të tjera financiare përmes bashkëpunimit me OJQ, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, strukturat e pushtetit lokal, donatorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe pushtetin qendror MKRS-në.

Çfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmbledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në dhjetor të vitit 2025. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së.

AKTIVITETE E MUAJIT JANAR

Gjatë këtij muaji Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

Vizita në objektet që janë në kuadër të drejtorisë.


Formimi i keshillit organizues për aktivitetin përkujtimor "Flaka e Janarit".

Takim njoftues me klubet sportive si dhe shoqëritë kulturore – artistike që veprojnë në Komunën e Rahovecit.

Takim njoftues me të gjithë operatorët e projekteve që operojnë në DKRS.

Homazhe përkujtimore për nder të "Flaka e Janarit" me datë 27.01.2025 në Celinë, Krushë të Madhe, Nagavc dhe Hoqë të vogël dhe tekë vendi I rënjes në Brestoc. Manifestimi përkujtimor është përmbyllur me ceremoninë përkujtimore në Qendrën Kulturore "Mensur Zyberaj", ku vlen të theksohet se u ndan edhe mirënjohje për të gjitha grate që kishin dhënë kontribut për gjatë viteve 1990 e që vazhdojnë të japin edhe sot.


DKRS në bashkëpunim me shoqatën e pedagogëve të kulturës fizike ka mbajtur garën shkollore në Futboll dhe Volejbol.



- **Shoqata e pedagogëve të kulturës fizike të Komunës së Rahovecit në bashkëpunim me Drejtorinë për kulturë, rini dhe sport, organizuan garat komunale në ping - pong me nxënësit e shkollave fillore të komunës sonë.**

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- Takim me MKRS, respektivisht me zyrtarin e departamentit të sportit për stadiumin e qytetit në Rahovec.
- **Për nder të 17 Shkurtit Ditës së Pavarësisë së Kosovës është formuar këshilli organizues lidhur me zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të kësaj dite**
- Pastrimi i Shtëpisë së Kulturës në Krushë të Madhe, Xërrxe, Drenoc dhe Ratkoc si brenda dhe jashtë hapësirave të objekteve, pastrimi i Muzeut "Uksin Hoti", pastimi i Muzeut të UÇK-së në Drenoc.
- Me datë 19.02.2025 është publikuar thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve, klubeve sportive, shoqërive kulturo-artistike etj., të komunës sonë.
- Me datë 12.02.2025 kanë filluar aktivitetet sportiv në Voelboll, sipas agjendës së këshillit organizues për nder të 17 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.
- Kanë përfunduar me sukses të gjitha aktivitetet e parapara për nder të 17 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.



- Janë mbajtur homazhe në nderim të heronjëve dhe dëshmorëve të kombit tek varrezat e dëshmorëve në Rahovec.
- Është organizuar aktivitete kulturore, përkujtimore e sportive në këtë organizim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Aktivitetet përkujtimore, kulturore e sportive në kuadër të shënimit të 17-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës u permbyllën me koncertin e shkollës së muzikës "Faik Sylka" nga nxënësit e kësaj shkolle.



Janë mbajtur takim me të rinjtë e Komunës së Rahovecit në Qendrën Rinore "SHL-Kosova", në takim është diskutuar për qështje të ndryshme, si aktivitetet e përbashkëta, trajnimet, debatet e aktivitetet


të lira për të rinjtë e Rahovecit. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka si mision fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje të të rinjve në jetën aktive shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore, duke respektuar veçoritë individuale tek të rinjtë.

Aktivitete në muajin Mars, gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

Në bashkëpunim me OVL-UÇK-në janë mbajtur aktivitetet e 5, 6 dhe 7 Marsit – Epopeja e UÇK-së. Kemi mbajtur takim me përfaqësuesit e OVL-UÇK-së, për organizimin e aktiviteteve përkujtimore që fillojnë nga data 25 mars, ku dhe është bërë agenda për homazhe nga data 25 Mars – 02 Prill 2025.

Vizita në të gjitha vendbanimet ku janë duke u kryer punët të cilat janë në kuadër të DKRS-së.

Në bibliotekën komunale “Sylejman Krasniqi” është mbajtur aktivitet për ditën botrore të Poezisë, aktiviteti u mbajt në bashkëpunim me klubin letrarë “Xhevdet Bajraj”.




Është formuar këshilli organizues për edicionin e 24-të i Festivalit Folklorik “Anadrinia Jehon” 2025.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit u bëri thirrje të gjithëve, Klubeve, Shoqatave sportive të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar e fushat sportive, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që do të kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e sportit dhe organizimin rinor gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Rini dhe Sport, në Komunën e Rahovecit.

Aktivitetet në muajin Prill, në bashkëpunim me Organizatën e Veteranëve në komunën tonë janë mbajtur të gjitha aktivitetet në nderim të dëshmorëve në komunën e Rahovecit.

Më 17.04.2025 është bërë nënshkrimi i kontratave në mes të kryetarit të komunës z. Smajl Latifi me 30 OJQ përfituese nga subvencionet, vlera totale e subvencioneve ka qenë **223,800.00euro**.



Më 12.04.2025 në palestren sportive "Mizahir Isma" është zhvilluar ndeshja ndërkombëtare në FUTSALL në mes të kombëtarës së Shqipërisë dhe Danimarkës.



Organizimi i aktiviteteve për "Javën së Dëshmorëve" nga 5-12 maj. Manifestimi qendror është mbajtur në Kompleksin Memorial në Gradish dhe DKRS ka qenë bartëse e të gjitha aktiviteteve.



Njëkohësisht është mbajtur Festivali i folklorit "Anadrinia Jehon", më 11,12 dhe 13 Maj në fshatin Dejnë, përveq grupeve artistike pjesëmarrës në festival musafire speciale ka qenë këngëtarja Shkurte Fejza, në të tri netët e këtij festivali tradicional DKRS ka qenë e përfshirë me gjithë potencialin njerëzor e material. Festivali ka pasur rrjedhë të rregullt dhe pa incidente.



Më 28 maj është organizuar aktiviteti qendror në shënim të Ditës së Qendrës Kulturore “Mensur Zyberaj”, aktivitete është mbajtur në Qendrën Kulturore.

Më 1 qershor, në bashkëpunim me SHPG “Hareja” është shënuar Dita Botërore e Fëmijëve, aktivitet që është mbajtur në Qendrën e Kulturës “Mensur Zyberaj” në Rahovec.

Në shënim të ditë së Çlirimit të Rahovecit janë organizuar aktivitete nga data 10 -14 qershor. DKRS ka qenë pjesë e Këshillit Organizues dhe ka qenë e përfshirë aktivisht në organizimin e këtij aktiviteti.

Më 17 qershor, në shënim të ditëlindjes së atdhetarit e politologut Profesor Ukshin Hoti, në Kompleksin kulturor – historik “Ukshin Hoti” është organizuar ndarja e dekoratës komunale “Ukshin Hoti”. DKRS është marrë me të gjitha përgatitjet për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti kulturor e përkujtimor.

Aktivitetet për pritjen dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet mërgimtarëve dhe autoriteteve vendore, kanë nisur zyrtarisht më 15 korrik 2025, në Kompleksin përkujtimor e kulturor në Gradish, u organizua ceremonia hapëse e aktiviteteve me koncert nga ansambli i këngëve dhe valleve “Agimi” nga Prizreni. Në këtë mbrëmje hapëse u paraqitën edhe artistë vendor, emra të njohur të estradës shqiptare. Në këtë aktivitet ishin edhe shumë mërgimtarë.




Me vendim të Kryetarit të Komunës hapësira për parkim të automjeteve ka qenë e rezervuar nga 15.07.2025-15.08.2025 vetëm për mërgimtarët dhe ky vendim është respektuar me korrektësi, ndërsa për lehtësim të procedurave të pajisjes me dokumentacion, në administratë është caktuar edhe sportel i veçantë për mërgimtarë. Drejtoria për Administratë ka lëshuar **6345** dokumente të dryshme.



Në funksion të ndërlidhjes sa më të mirë ndërmjet bizneseve vendore e atyre në mërgatë, në lokalitetin hotelier “Natyra” u mbajt takimi i përbashkët i biznesmenëve mërgimtarë dhe disa bizneseve vendore. Komuna në këtë rast ka luajtur rol në ofrimin e mundësive për bashkëpunim dhe shfrytëzim të resurseve njerëzore, natyrore e materiale të komunës së Rahovecit.



Meqë mërgimtarët dhe në veçanti fëmijët e tyre paraqesin shqetësim në përshtatje dhe aklimatizim, Drejtoria për Shëndetësi e Përkujdesje Sociale, në bashkëpunim me QKMF “Dr. Fahredin Hoti”, kanë organizuar kontrolle mjekësore falas në ambiente të hapura (23.07.2025). Me këtë rast janë realizuar kontrolle mjekësore nga mjekët dhe infermierët e QKMF-së.




Në kuadër të këtyre aktivitetëve janë organizuar gara në futboll të vogël, gara në shah, si dhe janë përruruar hapësira rekreative për fëmijë, hapësira (parkingje) infrastrukturore. Turneu i futbollit për “dëshmorët dhe Martirët” e Krushës së Madhe u organizua në bashkëpunim me të rinjtë dhe “KF Bashkimi” ku morën pjesë 64 ekipe. Ky turne ka zgjatur nëntëmbëdhjetë ditë. Pjesëmarrja ka qenë masive dhe mbarëvajtja ka qenë shembullore.




Bashkëpunimi me shoqërinë civile ka qenë shumë domethënëse, me ç'rast më 6 dhe 7 gusht u organizua manifestimi “FARDIFEST”, në Kompleksin përkujtimor e kulturor në Gradish. Në këtë festë pati prezantim të vlerave tona kulturore të traditës, vlera artistike muzikore tradicionale, si dhe prezantim të ushqimeve e pijeve tradicionale të zonës së Rahovecit.




Në këtë vazhdë në Krushë të Madhe, më 8, 9 e 10 gusht, u mbajt manifestimi tradicional “AGROFESTA”, ku u prezantuan prodhimet bujqësore vendore, industria e përpunimit të perimeve, si dhe ritet e kultura popullore e kësaj zone. Pjesëmarrja e prodhuesve, përpunuesve dhe e qytetarëve ka qenë e kënaqshme, ndërsa është përmbushur edhe një synim i këtij aktiviteti –ndërlidhja e zinxhirit prodhues-përpunues-konsumator.



Në Bibliotekën Komunale „Sulejman Krasniqi” u prezantua krijimtaria letrare për fëmijë e autores Shkëndije Shala, mërgimtare në Kanada. Aktiviteti u organizua nga DKRS dhe autorja.



Gjatë kësaj kohe nuk janë lënë në harresë as më të vegjlit, respektivisht fëmijët me nevoja të veçanta. Më 4.08.2025, në parkun e qytetit Toni e Mici u mbajt një aktivitet argëtues “Kids party”, në bashkëpunim me shoqatën e Pavarur të Gruas “Hareja”. Në këtë aktivitet morën pjesë numër i konsiderueshëm i fëmijëve dhe të rinjve, me ç’rast u organizuan lojëra e argëtime të ndryshme.



Organizimi i aktiviteteve kulturore ka qenë i mirë dhe me pjesëmarrje të konsiderueshme të qytetarëve. Sofra e mërgimtarit, aktivitet tradicional ky shumë i dëshiruar nga mërgimtarët, ka tërhequr vëmendjen e shumë pjesëmarrësve. Në fshatin Xërxë, në bashkëpunim me Këshillin e fshatit dhe bizneseve vendore, u mbajt aktivitet muzikor e argëtuese, që tërhoqi shumë mërgimtarë.



Muaji i mërgimtarëve është shoqëruar edhe me organizime të ndryshme kulturore e artistike, me ç'rast në rrugën "Xhevat Kasapi", (afër palestrës së sportit), janë organizuar mbledhje muzikore ku kanë prezantuar vlera muzikore grupe dhe artistë vendor. Organizimi i këtyre mbledhjeve është bërë në bashkëpunim me Komunën e Rahovecit (DKRS) dhe shoqërinë civile.

Organizimet e shumta për mërgimtarët kanë vazhduar me ceremoninë e ndarjes së Dekorates Komunale për Humanizëm "Dr. Ali Sokoli", aktivitet që u mbajt 12.7.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës, ku ishin të pranishëm numër i konsiderueshëm qytetarësh e veprimtarësh. Dekorata postmortem iu nda mjekut humanist Samedin Haxhijaha.



Në parkun e qytetit nga DKRS, shoqata e artistëve „ArtStudio” dhe vullnetarët e rinj të SHL Kosova u hap ekspozita me fotografi e artikuj të gazetave të periudhës 1998-99, mbledhur dhe përgatitur nga mërgimtari Isuf Morina. Në këtë ekspozitë qytetarët patën mundësi të rikthehen në kohë prë të kujtuar luftën dhe sakrificat e popullit shqiptar për liri e pavarësi.



Ndonëse ishin planifikuar pesëmbëdhjetë aktivitete të ndryshme, gjatë kësaj kohe janë realizuar gjithsej 22/23 aktivitete kulturore, artistike, sportive dhe aktivitete të tjera që ndërlidhen me mërgimtarët tanë.

Konsiderojmë se, të gjitha aktivitetet kanë pasur ecuri normale dhe nuk janë regjistruar incidente apo ngecje në procesin e përmbushjes së programit të paraparë, duke përgëzuar Policinë e Kosovës - stacionin policor në Rahovec dhe QKMF-në, që ishin të pranishëm në të gjitha aktivitetet duke u kujdesur për mbarrëvajtjen dhe sigurinë e qytetarëve tanë.

BIBLOTEKA KOMUNALE "SULEJMAN KRASNIQI" - RAHOVEC

- Përgaditja e raporteve mujore dhe vjetore
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit

Gjatë kësaj periudhe, kemi bashkëpunuar me dashamirës të librit: mësimdhënës, nxënës, shkrimtarë të komunës sonë, në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijes rreth lexueshmërisë.

Biblioteka në tërësi ka ruajtur vazhdimësinë e punës së saj profesionale në shërbim të lexuesve, të atyre përdoruesve që kanë pasur nevoja për shërbime të ndryshme, si në kërkim të librit, në shfrytëzim të sallës dhe shërbimeve të tjera.

Anëtarësia dhe libra të lexuara

Janar-Nëntor	Anëtar të regjistruar	Të rinjë		Të rritur		Me pagesë	Falas	Lib. të lexuara
		Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra			
Rahovec	481	171	283	11	16	471	10	2893
Krushë	31	8	20	3	0	31	0	758
Ratkoc	29	11	17	0	1	29	0	242
Gjithsej	541	190	320	14	17	531	10	3893

Përbërja sociale e lexuesve

Janar-Nëntor	Nxënës	Studentë	Punëtor	Bujq	Amvise	Të tjerë	Gjithsej
Rahovec	454	11	1	0	1	14	481
Krushë e Madhe	28	0	0	0	0	3	31
Ratkoc	28	0	0	0	0	1	29
Gjithsej	510	11	1	0	1	18	541

Salla e leximit - Pasurimi i fondit librar - Fondi librar në biblioteka

Janar-Nëntor	Salla e leximit	Pasurimi i fondit librar	Fondi librar në biblioteka
Rahovec	73	1156	23830
Krushë e Madhe	60	0	4558
Ratkoc	57	0	1840
Gjithsej	190	1156	30228

PALESTRA SPORTIVE "MIZAHIR ISMA"

- PALESTRA E SPORTEVE "MIZAHIR ISMA"

Gjatë kësaj periudhe Jana-Dhjetor në palestrën sportive "Mizahir Isma" janë realizuar aktivitetet të shumta sportive, si nga klublet të Komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga klube tjera, **vlenë të theksohet se për here të parë në Palestren e Sporteve "Mizahir Isma" më 12 prill 2025 është zhvilluar ndeshja nderkomëtare në futsal në mes të kombëtarës së Shqipërisë dhe Danimarkës, ndeshja është e regjistruar në FSHF dhe UEFA.** Ndër aktivitetet tjera janë: **Klubi Hendbollistik "KH-Rahoveci"**, garon në Superligën e Hendbollit të Kosovës. Në muajt janar-dhjetor janë zhvilluar 34(tridhjet e katër) ndeshje zyrtare në Palestër, KH Rahoveci është **Kampion në Hendboll.**

Klubi i Futsallit "FC-Rahoveci 2019", garon në ligën e parë të Kosovës dhe ambiciet kryesore të ekipës janë hyrja në Superligë të Kosovës.

Klubi i basketbollit "Grapeland" tani me emër të ri KB "Rahoveci 029" nga Rahoveci, aktualisht garojnë në superligën e Kosovës, synimet e klubit janë që të jenë në elitën e basketbollit dhe të jenë kampion të Kosovës.

Zhvillimin e garave në Pin-Pong nga shoqata e pedagogëve të kulturës fizike pjesëmarrës kanë qenë shkollat fillore nga komuna e Rahovecit.

- Turnir për nder Ditës së Pavarësisë 17 shkurt ku kanë qenë pjesëmarrës të gjitha ekipet nga komuna e Rahovecit. Turniri është zhvilluar në futboll të vogël dhe volejbol.
- Aktivitete të organizuar për muajin e mërgimtarëve, aktivitete për festat e nëntorit 2025 dhe shumë aktivitete tjera në nivel lokal, kombëtarë e ndërkombëtarë.

Drejtria për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë vitit **2025** ka organizuar dhe ka mbajtur aktivitete të shumta Kulturore e Sportive, gjithësej janë mbajtur **130 aktivitete**, gjithashtu gjatë këtij viti janë rregulluar hapësira të shumta rekreative për të rinj si Fusha Sportive e kënde të lojrave për fëmijë në qytet dhe vendbanime tjera të komunës sonë, në komunën tonë kemi mbi **20.000m2** sipërfaqe për zhvillimin e aktiviteteve sportive për të rinjë, duke përfshirë Palestren e sporteve "Mizahir Isma" dhe "Kompleksin Sportiv" tekë Epopeja e UÇK-së.

PËRFUNDIMI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2025 është angazhuar në aktivitete dhe punë të ndryshme si:

- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
- Vizitë objekteve kulturore e sportive;
- Takime me klube dhe shoqata sportive;
- Vizitë kompleksëve muzeore;
- Takim me rini dhe shoqata e organizata rinore;
- Organizimi i aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive;
- Monitorimi i aktiviteteve të subvencionuara nga DKRS-ja;
- Takime të rregullta në kuadër të DKRS-së;
- Përgaditje të raporteve javore, mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore.

Rahovec, dhjetor 2025

